



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

**Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që
veprojnë për llogari të tyre**

Adresa: Bulevardi: “Zhan D’Ark” Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: @avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok.202201472/13

Tiranë ___/___/2023

Lënda: *Rekomandim lidhur me respektimin e të drejtave të subjektit të prekur nga procedurat administrative të ndjekura nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, mbi ndërtimet e Kompleksit Turistik “Prestige Holiday Resort” të ndodhur në Golem, Bashkia Kavajë.*

Drejtuar: **Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit**

TIRANË

Z.Kryeinspektor!

Sikurse jeni në dijeni, Institucioni i Avokatit të Popullit (në vijim AP), në ushtrim të kompetencave kushtetuese e ligjore për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve shqiptarë dhe të huaj që jetojnë në territorin e RSH, ka marrë në administrim ankesën e subjektit “Erjoni” shpk, i cili pretendon shkeljen e së drejtës të pronësisë, e ardhur prej procedurës administrative të ndjekur prej IKMT-së në lidhje me zbatimin e kuadrit rregullator, ligjit nr.107, datë 31.07.2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, ligjit nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, VKM-së nr.894, datë 04.11.2015, “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore”, dhe VKM-së nr.408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”.

Në këtë ankesë, subjekti ankues pretendon, ndër të tjera, se më datë 18.08.2022, inspektorët e IKMT-së Tiranë, pa asnjë njoftim paraprak, kanë ardhur në kompleksin turistik “Prestige Holiday Resort”, duke prishur/shembur një pjesë të objektit, përkatësisht murin kufitar të pronës, ndërtimi i të cilit është miratuar sipas subjektit “Erjoni” shpk, me vendimin nr.02, datë 07.03.2016 të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT). Këto veprime, sipas ankuesit, janë kryer prej organit/ve publik në cënim të së drejtës të pronësisë, respektimit të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor. Veprimtaria për prishjet në kompleksin turistik “Prestige Holiday Resort”, ka vijuar prej

IKMT-së në ditët në vijim, me mbajtjen e procesverbalit datë 25.08.2022, “Për konstatimin e kundërvajtjes” lidhur me ndërtimin e pistës në det dhe dy pishinave, pjesë përbërëse e kompleksit turistik “Prestige Holiday Resort”. Në vijim, ankuesi shprehet, se në ndryshim nga qëndrimi zyrtar i shprehur në shkresën nr.469/3 prot., datë 25.03.2017, drejtuar shtetases Iris Çeku, me lëndë: “Kthim përgjigje”, se:

“... Në informacionin zyrtar të ardhur me shkresën nr.3358/1 prot., datë 20.12.2016, ky Inspektorat (IMT-ja Kavajë) informon se shoqëria ndërtuese “Erjoni” sh.p.k. disponon vendim nr.02, datë 07.03.2016, Këshillit të Ministrave dhe të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin kompleks turistik “Prestige Holiday Resort”,

IKMT-ja, konsideron në procesverbalin datë 25.08.2022, “Për konstatimin e kundërvajtjes”, paligjshmëri në ndërtimin e pistës në det dhe dy pishinave, pjesë përbërëse e kompleksit turistik “Prestige Holiday Resort”, për të cilat nuk rezultojnë të jetë vendosur masë administrative më parë.

Përkundër veprimtarisë së IKMT-së, ankuesi deklaron se ka depozituar kërkesë pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për sigurimin e padisë, me objekt:

“Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke vendosur pezullimin e efekteve të aktit të konstatimit proces verbal nr.29, datë 25.08.2022 “Për Konstatimin e Kundërvajtjes” si dhe pezullimin e çdo akti, veprimi administrativ apo çdo masë tjetër që urdhëron prishje ndërtimesh nga ana e IKMT-së pranë Shoqërisë “Erjoni” shpk në kompleksin turistik “Prestige Holiday Resort”, Golem, Kavajë, ose çdo masë tjetër që do të vlerësohet e nevojshme nga gjykata”.

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.31132-05033-80 Akti, datë 31.08.2022, vendosi për mospranimin e kërkesës me arsyetimin se nuk ka ende një akt që të kundërshtohet. Ankuesi bën të ditur, se inspektorët e IKMT-së, dy ditë më vonë, pra më datë 02.09.2022, nisën prishjen e pistës në det dhe 2 pishinave. Referuar deklarimeve të ankuesit, prishja është bazuar në vendimin nr.342, datë 26.08.2022, “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm”, kopja e të cilit është vënë në dispozicion të tij dorazi, prej IKMT-së, po në këtë datë. Sipas vendimit nr.342, datë 26.08.2022, të IKMT-së është vendosur për:

“Dënimin e kundërvajtësit “Erjoni” Shpk me prishjen e objektit të kundërligjshëm pistë në det me sipërfaqe rreth 4,500 m², pishina me sipërfaqe rreth 590 m²; 450 m² ndodhur në adresën: kompleksi turistik “Prestige Holiday Resort” Golem, Bashkia Kavajë”.

Faktin e nxjerrjes së vendimit nr.342, datë 26.08.2022, “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm”, IKMT-ja nuk e ka bërë me dije subjektit “Erjoni” shpk apo Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në procesin gjyqësor për shqyrtimin e kërkesës për sigurimin e objektit të padisë dhe dhënies së vendimit nr.31132-05033-80 Akti, datë 31.08.2022, prej saj.

Ky qëndrim i mbajtur prej IKMT-së në procesin gjyqësor të zhvilluar, vlerësohet jo në përputhje me detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 15 të Kodit të Procedurës Civile, se:

“Palët janë të detyruara të japin ndihmesën e tyre për zvillimin normal të hetimit gjyqësor”,

...

si dhe nenin 26 të ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, se:

“Mosparaqitja e provave nga organi publik.

*1. Paraqitja e provave nga palët bëhet, në çdo rast, përpara seancës së parë gjyqësore.
...”.*

Mosparaqitja në cilësinë e provës e aktit administrativ, vendimit nr.342, datë 26.08.2022, “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm”, prej IKMT-së, në procesin gjyqësor të zhvilluar, gjykojmë se ka penguar zhvillimin normal të hetimit gjyqësor në gjykimin e kërkesës së subjektit “Erjoni” shpk, me objekt: “Sigurim i objektit të padisë”.

IKMT-ja, në ushtrimin e veprimtarisë administrative për çështjen në fjalë, nuk ka respektuar parimin e transparencës, dhënies së ndihmës aktive, sikurse parashikuar në nenin 5 dhe 10 të Kodit të Procedurës Administrative, se:

“Organet publike ushtrojë veprimtarinë administrative në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngusht me personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në të”,

1. Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre.

...

3. Organi publik, që zhvillon procedurën administrative, siguron që padija e palës të mos përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave që pala gëzon sipas ligjit.

Mosrespektimi i detyrimeve ligjore si më sipër parashikuar në dispozitat ligjore, prej IKMT-së, ka ndodhur para dhe gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor administrative.

Pra, veprimtaria e zhvilluar prej IKMT-së nuk mund të vlerësohet në përputhje me parimin e ligjshmërisë të parashikuar në nenin 4 të Kodit të Procedurës Administrative, se:

“1. Organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca.

2. Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor”.

Referuar dispozitës ligjore, nenit 4 të K.Pr.A., respektimi detyrimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor në marrëdhënie me subjektin “Erjoni” shpk, nuk ka ndodhur.

Kundër vendimit nr.342, datë 26.08.2022, “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm”, të IKMT-së, bërë të ditur subjektit “Erjoni” shpk, më datë 02.09.2022, është ngritur përsëri më këtë datë, kërkesë pranë gjykatës administrative të shkallës së parë për sigurimin e objektit të padisë me objekt: “Pezullim prishje ndërtimi”. Shqyrtimi i kësaj kërkesë është kryer më datë 06.09.2022, në kushtet kur objekti për të cilin është kërkuar vendosja e masës së sigurimit u prish në diapazonin kohor 02.09.2022 deri më datë 05.09.2022.

Zhvillimin e veprimtarisë për prishjen e objektit qysh në ditën e njoftimit të subjektit subjektit “Erjoni” sh.p.k. për këtë vendimmarrje, nuk e gjejmë në përputhje me parashikimet e nenit 1798 të K.Pr.A., se:

Ekzekutimi i menjëhershëm

- 1. Organi publik mund të ushtrojë në mënyrë përjashtimore një nga mënyrat e ekzekutimit të detyrueshëm, të parashikuara në nenet 176 dhe 177, të këtij Kodi, edhe pa nxjerrë paraprakisht një akt administrativ, nëse përmbushen të tre kushtet e mëposhtme: a) është e nevojshme marrja e një mase urgjente për të siguruar rendin dhe sigurinë publike, apo shmangur kërcënime a rreziqe të menjëhershme për jetën, shëndetin, apo pronën e personave;*
- b) për shkak të urgjencës ekstreme për marrjen e masës, akti administrativ, që urdhëron plotësimin e një detyrimi jofinanciar, nuk mund të nxirret në kohë;*
- c) nuk mund të gjendet menjëherë pala, apo përfaqësuesi, të cilit do t'i drejtohet akti, për urdhërimin e plotësimit të një detyrimi jofinanciar*

Pra, IKMT-ja nuk është ndodhur në asnjë nga kushtet e parashikuara në pikën “a”, “b” dhe “c” të dispozitës ligjore të sipërcituar, për rrjedhojë, veprimtaria e saj nuk mund të konsiderohet në përputhje me parashikimet ligjore.

Referuar parashikimeve të nenit 14 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*”,

“Kundër vendimit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe atij të njësisë vendore lejohet ankimi i drejtpërdrejtë në gjykatë brenda 10 ditëve, duke filluar nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi gjyqësor kundër vendimit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe atij të njësisë vendore nuk pezullon ekzekutimin e tij”,

kuptohet se ekzekutimi i vendimit do duhet të niste pas dhjetë ditëve nga dita e njoftimit të vendimit nr.342, datë 26.08.2022, “*Për prishjen e objektit të kundërligjshëm*”.

Gjykojmë se, veprimtaria administrative për prishjen e objektit prej IKMT-së qysh në ditën e njoftimit të vendimit subjektit pronar, nuk vjen në përputhje me parimin për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, si rrjedhojë e moslënies së afatit të ankimit efektiv apo zbatimit vullnetar të tij prej “Erjoni” sh.p.k..

Në këtë situatë të çështjes, ankuesi, informon se më datë 24.11.2022, është njoftuar me anë të shkresës nr.3850 Prot., datë 21.11.2022, prej Agjencisë të Zhvillimit të Territorit, për refuzimin e aplikimit për leje ndërtimi për objektin kompleks turistik “*Prestige Holiday Resort*”, me vendndodhje në Golem, Bashkia Kavajë, me subjekt zhvillues “Erjoni” sh.p.k, të cilës i është bashkëlidhur vendimi nr.11, datë 19.10.2022, i KKT-së.

Në vijim të veprimeve administrative, IKMT-ja më datë 01.12.2022, në prani të forcave të Policisë së Shtetit, ka kryer rrethimin e gjithë kompleksit turistik “*Prestige Holiday Resort*”. Për këtë veprim të kryer, subjekti ankues shprehet se nuk i'u dorëzua dokumentacion prej IKMT-së për justifikimin e tij.

Kundër këtij veprimi, ankuesi informon se bëri përsëri kërkesë datë 01.12.2022, në gjykatën administrative të shkallës së parë, për sigurimin e objektit të padisë. Seanca gjyqësore për shqyrtimin e kërkesës datë 01.12.2022, u caktua data 05.12.2022, ora 13.00. Një ditë përpara shqyrtimit të kërkesës datë 01.12.2022, nga gjykata, IKMT-ja kreu shembjen/prishjen e godinës nr.5, pjesë përbërëse e kompleksit turistik “*Prestige Holiday Resort*”, me vendndodhje në Golem, Bashkia Kavajë.

Në seancën gjyqësore të zhvilluar më datë 05.12.2022, prej gjykatës administrative të shkallës së parë, ankuesi, shprehet se u njoh me procesverbalin nr.6, datë 25.11.2022 “*Për konstatimin e kundërvajtjes*”, vendimin nr.464, datë 30.11.2022, “*Për prishjen e objektit*

të kundërligjshëm”, vendimin nr.465, datë 30.11.2022, “Për dënimin me gjobë”, të nxjerra prej IKMT-së për prishjen e godinës nr.5, të cilat ende nuk i janë njoftuar zyrtarisht subjektit “Erjoni” shpk në kopje origjinale apo të njehsuar me origjinalin.

IKMT-ja konstatohet se ka ripërsëritur qëndrimin e parregullt dhe jo në përputhje me ligjin, sikurse ndodhur në rastin e nxjerrjes së vendimit nr.342, datë 26.08.2022, “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm”.

Mbajtja e proces verbalit datë 25.11.2022, sipas ankuesit, nuk është kryer në ambientet e kompleksit turistik “Prestige Holiday Resort”, referuar pamjeve filmike të kamerave të sigurisë të vendosura në kompleks. Kjo veprimtari referuar deklarimeve të ankuesit është bërë objekt kallzimi në organin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Në lidhje me sa sipër, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion prej ankuesit si dhe deklarimeve të tij, Avokati i Popullit, ka zhvilluar veprimtari hetimore administrative, duke kërkuar IKMT, informacion rreth veprimeve të kryera mbi njësitë ndërtimore, pjesë përbërëse të kompleksit turistik “Prestige Holiday Resort”. Në përgjigje të kërkesës nr.K3/A53-4 Prot, datë 12.12.2022, ju me Tuajën nr.576 Prot, datë 24.01.2023, justifikoni mosdhënien e informacionit të kërkuar duke deklaruar, se:

“... ju bëjmë me dije se dokumentacioni i administruar nga IKMT është sekuestruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë”.

Në kushtet e prezantuara prej IKMT-së me shkresën nr.452/1 Prot, datë 23.02.2023, kemi kërkuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, vënien në dispozicion të kopjeve të akteve, shkresave, ekstrakteve të sekuestruara IKMT-së si dhe çdo organi tjetër që ka lidhje me këtë çështje. Në përgjigje të kërkesës, organi Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, shprehet, se:

“... ju bëjmë me dije se do t’ju vihen në dispozicion në përfundim të hetimeve”.

Në vijim të qëndrimit të shprehur prej organit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, i jemi ridrejtuar këtij organi me shkresën nr.K3/A53-2 Prot, datë 20.04.2023, për dhënien e informacionit të munguar. Deri më sot ky organ nuk ka përmbushur detyrimin ligjor ndaj Avokatit të Popullit. Sa më sipër është në shkelje të parashikimeve kushtetuese e ligjore e do të jetë pjesë e një rekomandimi të veçantë të Avokatit të Popullit.

➤ Parashtrimi i fakteve dhe rrethanave

Ligji nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, ka për qëllim të sigurojë respektimin e normave, standardeve, kushteve zhvillimore dhe legjislacionit në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit e burimeve ujore në të gjithë vendin, si dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, bazuar në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit, të decentralizimit dhe subsidiaritetit, në bazë të ndarjes administrative.

Sipas këtij ligji, IKMT-ja dhe IMT-të vendore janë parashikuar si organe për inspektimin ndërtimor e urbanistik, i organizimit, i rregullave të funksionimit dhe i përgjegjësive të tyre.

Ligji nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, ka për për objekt përcaktimin e parimeve bazë, përgjegjësive dhe rregullave për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në Republikën e Shqipërisë

Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore;
- b) të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillimin e territorit në nivel kombëtar e vendor, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publikë e privatë, duke bashkërenduar punën për:
 - i) mbrojtjen e burimeve natyrore, si: toka, në veçanti toka bujqësore, ajri, uji, pyjet, flora, fauna, peizazhet;
 - ii) krijimin e garantimin e territoreve të ndërtueshme, të organizuara në mënyrë të harmonizuar e funksionale, duke i dhënë përparësi hapësirës publike, mundësisë së banimit për të gjitha shtresat ekonomike e sociale, krijimit të infrastrukturës fizike të përshtatshme për nxitjen e investimit në ushtrimin e veprimtarive ekonomike, sociale e kulturore, lehtësimin të përdorimit të sigurt të shërbimeve e komoditeteve publike, të transportit, komunikimit dhe infrastrukturës, përfshirë territoret e përshtatura;
 - iii) nxitjen e jetës ekonomike, shoqërore e kulturore në nivel kombëtar e vendor;
 - iv) garantimin e burimeve të furnizimit të mjaftueshëm dhe veçanërisht atij jetësor;
 - v) garantimin e kushteve të sigurisë së jetës dhe të shëndetit publik, rendit publik dhe sigurisë kombëtare;
 - vi) nxitjen e zhvillimit të balancuar rajonal për të siguruar shpërndarje të qëndrueshme të popullsisë në vend në bazë të burimeve;
- c) të nxitë veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike, zonave të mbrojtura, monumenteve të natyrës, zonave të ndjeshme mjedisore dhe të peizazhit;
- ç) të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës, në përputhje me dokumentet planifikuese dhe sipas legjislacionit mjedisor në fuqi;
- d) të krijojë kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale për të gjitha kategoritë sociale, kohezion ekonomik e social dhe gëzim të të drejtave të pronësisë;
- dh) të sigurojë që autoritetet kombëtare e vendore të planifikimit të hartojnë e të përditësojnë rregullisht dokumentet e planifikimit, sipas kërkesave të tregut dhe nevojave sociale;
- e) të sigurojë që autoritetet e planifikimit të bashkërendojnë veprimtaritë e tyre planifikuese për të nxitur planifikimin e harmonizuar e të integruar të territorit;

Më tej, me VKM nr.894, datë 04.11.2015, “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtje së Territorit dhe ai njësisë vendore”, janë përcaktuar procedurat e unifikuara të kontrollit të territorit prej organeve të lartpërmendura.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion prej subjektit “Erjoni” shpk, rezulton, se, “Prestige Holiday Resort”, është një kompleks turistik i ndodhur në Golem, Bashkia Kavajë.

1. Ndërtimi i këtij objekti ka nisur fillimisht prej “personi i stimuluar”, subjekti “MAK-ALBANIA” SHPK. Ky subjekt, më datë 25.03.1996 në cilësinë e qiramarrësit ka lidhur kontratën e qirasë me qiradhënësin ish-Ministria e Ndërtimit dhe Turizmit për marrjen me qira për 25 (njëzet e pesë) vjet, të pasurisë, sipërfaqes së tokës prej 79810 m², të ndodhur në Golem, Bashkia e Kavajës, me qëllim ndërtimin e një kompleksi turistik.
2. Leja e ndërtimit për ndërtimin e fshatit turistik është miratuar nga **ish-Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr.15 datë**

- 18.12.2004** *“Për Miratimin e rishikimit urbanistik dhe Lejes së Ndërtimit të Fshatit Turistik për Parcelën Nr. 14 në zonën turistike Golem, për subjektin “MAK – ALBANIA”*, për ndërtimin e sipërfaqes ndërtimore prej 4892 m². Sheshi ndërtimit prej 80000 m², destinacioni e funksioni i tij, kondicionet urbane, etj, janë miratuar me vendimin nr.32, datë 20.12.2004, ish-KRRT-së.
3. Me rastin e përfundimit të ndërtimeve, në dhjetor të vitit 2006, është hartuar Akt Kolaudimi i objektit *“Fshat turistik në parcelën Nr. 14, Golem”*, dhe janë bërë verifikimet mbi dokumentat dhe faktin e ndërtimeve në terren, nga kolaudatori ing.Ibrahim Rreshka. Me anë të shkresës me lëndë: *“Dërgim dokumentacioni”*, nr.3050/1 Prot., datë 29.03.2007, Drejtoria e Urbanistikës Ligjore dhe Kontrollit mbi Territorin i ka dërguar ish-Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë, dokumentacionin për regjistrimin përfundimtar të objektit *“Fshat Turistik”*, si më poshtë renditur:
 - 3.1. Leja e sheshit të ndërtimit;
 - 3.2. Leja e ndërtimit;
 - 3.3. Vendimi i KRRTRSH për miratimin e studimit urbanistik;
 - 3.4. Planvendosja e sheshit të ndërtimit të objektit e miratuar;
 - 3.5. Certifikata e pronësisë së tokës;
 - 3.6. Projekti arkitektonik i objektit i miratuar;
 - 3.7. Akti i kolaudimit tekniko ekonomik të objektit;
 - 3.8. Akti i kontrollit përfundimtar dhe sistemimeve të objektit;
 - 3.9. Leja e shfrytëzimit të objektit.
 4. Drejtoria e Urbanistikës Ligjore dhe Kontrollit mbi Territorin, gjithashtu ka lëshuar Lejen e Shfrytëzimit me nr. 3050/1 Prot., datë 29.03.2007 për objektin: *“Fshat turistik sipas rishikimit të studimit urbanistik në Parcelën nr. 14 - Golem”*, ndodhur në fshatin Golem të Komunës Golem, me investitor Shoqëria *“MAK ALBANIA”* sh.p.k., në një sipërfaqe sheshi ndërtimi prej 80.000 (tetëdhjetë mijë) m² dhe sipërfaqe të ndërtimit sipas lejes së sheshit prej 4,892 (katër mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e dy) m².
 5. Më datë 20.04.2007 është përgatitur plan rilevimi për Pasurinë me nr. 137/22, Zona Kadastrale 1791, Kavajë, i punuar nga ing.Alvira Aliaj me pronar *“MAK ALBANIA”* SHPK.
 6. Pas këtij momenti, shoqëria *“MAK ALBANIA”* SHPK ka negociuar me shoqërinë *“Erojoni”* shpk transferimin e kontratës së qirasë me ish-Ministrinë e Turizmit dhe Ndërtimit në favor të këtij të fundit. Për këtë qëllim, midis palëve *“MAK ALBANIA SHPK”* (Transferuesi) dhe *“Erjoni”* shpk (Pranuesi) është lidhur Kontratë Shitje dhe Transferimi me nr.6963 Prot., nr.0111 Kol., datë 06.11.2014, me anë të së cilës palët kanë rënë dakord për transferimin e 30 (tridhjetë) pasurive të paluajtshme të regjistruara pranë ish-ZRPP Kavajë, si dhe kontratës së qirasë dhe marrëveshjes së zhvillimit tek Pranuesi *“Erjoni”* shpk, përkundrejt çmimit 1.526.000 (një milion e pesëqind e njëzet e gjashtë mijë) Euro për pasuritë e paluajtshme dhe 274.000 (dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë) Euro për pasuritë e luajtshme.
 7. Transaksioni i mësipërm i transferimit dhe përfitimi i titullit *“Person i stimuluar”* nga ana e *“Erjoni”* shpk është miratuar nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit me Urdhrin nr.7 Prot., datë 07.01.2015 *“Për miratimin e transferimit të titullit “Person i stimuluar” dhe marrëveshjeve përkatëse të qirasë dhe zhvillimit nga subjekti “MAK ALBANIA” shpk, tek subjekti “Erjoni” shpk”*.
 8. Më datë 22.01.2015 është nënshkruar një Shtesë e *“Marrëveshjes së Qirasë të lidhur në datën 25.03.1996 ndërmjet Ministrisë së Ndërtimit dhe Turizmit për Turizmin dhe Personit të Stimuluar Shoqërisë “MAK ALBANIA” shpk”* me nr.449 Rep., nr.176 Kol., ndërmjet palëve Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit të Republikës së Shqipërisë dhe Personit të stimuluar Shoqëria *“Erjoni”* shpk, në të cilën palët kanë rënë dakord për

zëvendësimin e palës qiramarrëse nga subjekti “MAK ALBANIA” shpk tek subjekti “Erjoni” shpk.

9. Po në këtë datë, është nënshkruar një Shtesë e “Marrëveshjes së Zhvillimit të lidhur në datën 25.03.1996 ndërmjet Ministrisë së Ndërtimit dhe Turizmit dhe Personit të Stimuluar Shoqërisë “MAK ALBANIA” shpk” me nr.450 Rep., nr.179 Kol., ndërmjet palëve Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit të Republikës së Shqipërisë dhe personit të stimuluar Shoqëria “Erjoni” shpk, në të cilën palët kanë rënë dakord që të bëhet zëvendësimi i palës zhvilluese në Marrëveshjen e Zhvillimit të datës 25.03.1996, duke u zëvendësuar nga subjekti “MAK ALBANIA” shpk tek subjekti “Erjoni” shpk.
10. Pas transferimit të kompleksit, Komuna Golem më datë 26.05.2015 ka lëshuar Lejen e Ndërtimit me nr.1952 Prot., për shoqërinë “Erjoni” shpk, për punimet: “Rikonstruksion Godina 3 kat + Godinë Multifunkionale + Godina 1 kat në varg”.
11. Më tej, bazuar në aplikimin e kërkuarit “Erjoni” shpk, Këshilli Kombëtar i Territorit me vendimin nr.02, datë 07.03.2016 “Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin: “Kompleks Turistik “Prestige Holiday Resort”, me vendndodhje në Golem, Bashkia Kavajë”, ka vendosur: “Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin “Kompleks Turistik “Prestige Holiday Resort”, me vendndodhje në Golem, Bashkia Kavajë”, me subjekt kërkuar shoqërinë “Erjoni” sh.p.k. Vendimi hyn në fuqi menjëherë”.
12. Miratimi me kusht i Lejes së Ndërtimit për objektin “Kompleks Turistik “Prestige Holiday Resort”..., është pasuar nga kërkesa e subjektit “Erjoni” shpk për ndryshim projekti gjatë ndërtimit, për objektin “Shtesë volumi dhe rishikimi i kushteve të lejes së ndërtimit për objektin “Kompleksi turistik “Prestige Holiday Resort”, me vendndodhje në Golem, Bashkia Durrës, me zhvillues Shoqëria “Erjoni” shpk. Kjo kërkesë sipas vendimit nr.2334/1 Prot, datë 24.09.2018, të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit është refuzuar.
13. KKT-ja në lidhje me vendimin nr.02, datë 07.03.2016, ka vendosur me vendimin nr.11, datë 19.10.2022, për:

“1.Të deklarojë përfundimin e procedurave administrative për 24 aplikime, të paraqitura për miratim Leje Ndërtimi pranë KKT-së, të cilat nuk janë pajisur me dokumentin e lejes së ndërtimit, pasi janë braktisur nga aplikuesi, duke mos shprehur interes për vazhdimin e tyre, nëpërmjet mosplotësimit të kushteve të përcaktuara në vendimin e KKT-së dhe dokumentacion përkatës sipas legjislacionit në fuqi.

2.Aplikimet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, të cilët i përkasin periudhës kohore 2015-2018, evidentohen në dy listat e poshtëshënuara, të cilat bashkangjiten dhe bëhen pjesë e këtij vendimi:

a) “Lista 1” ku pasqyrohen aplikimet e deleguara në rrugë shkresore nga AKPT-ja

b) “Lista 2”, me aplikime të paraqitura pranë AZHT-së.

3.Sekretariati Teknik i KKT-së të marrë masat për zhvillimin e procedurës së refuzimit të aplikimeve të listave 1 dhe 2, sipas rastit, në rrugë shkresore, ose nëpërmjet sistemit e-leje.

4.Ngarkohet AZHT-ja për zbatimin e këtij vendimi.

5.Ky vendim hynë në fuqi menjëherë”.

Në procesin e zbatimit të vendimit nr.11, datë 19.10.2022, AZHT-ja me shkresën nr.3850 Prot, datë 21.11.2022, ka njoftuar Shoqërinë “Erjoni” shpk për këtë vendimmarrje.

14. **Inspektoriati Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkisë Kavajë, në përgjigje të kërkesës së Institucionit të Avokatit të Popullit, me shkresën nr.1599/1 Prot, datë 04.05.2023, informon, midis të tjerave, se:**

“... në periudhën 23.12.2016, janë konstatuar punime informale ku janë mbajtur aktet e konstatimit dhe pezullimit të punimeve”.

15. Për sa më sipër cituar në pika 13, është në dijeni edhe Ministria e Turizmit, e cila më 08.07.2021 ka lidhur me subjektin “Erjoni” shpk Aneksin II “*Rinovim i Kontratës së Qirasë të lidhur më datë 25.03.1996, ndërmjet Ministrisë së Ndërtimit dhe Turizmit dhe Personit të Stimuluar shoqërisë “MAK-ALBANIA” SHPK, transferuar titulli “person i stimuluar” tek “Erjoni” shpk*”, me të cilën ka rinovuar kontratën e qirasë për një afat tjetër 25 vjeçar.
16. Sikundër referohet në të dhënat paraprake të këtij Aneksi II, rinovimi është propozuar nga Agjencia Kombëtare e Turizmit pasi: “... subjekti “Erjoni” sh.p.k., gjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëdhënie kontraktuale, ka realizuar në mënyrë korrekte detyrimet që rrjedhin nga marrëveshja e qirasë dhe ka plotësuar kriteret e Marrëveshjes së Zhvillimit si dhe vazhdon të ushtrojë veprimtarinë në fushën e turizmit si strukturë akomoduese”.
17. Më 18.08.2022 pa asnjë njoftim në kompleksin turistik *Prestige Holiday Resort*” janë kryer veprime për prishjen e murit rrethues të kompleksit nga ana e inspektorëve të IKMT-së. Në vijim, inspektorët e IKMT-së kanë mbajtur proces-verbalin nr.29, datë 25.08.2022 “*Për konstatimin e kundërvajtjes*”, si dhe nxjerrë vendimet nr.342, datë 26.08.2022, “*Për prishjen e objektit të kundërligjshëm*” dhe nr.343, datë 26.08.2022 “*Dënimin me gjobë*”, të cilët rezultojnë të komunikuar subjektit “Erjoni” shpk me shkresën nr.s’ka, datë 02.09.2022, ditën kur ka filluar dhe prishja e objekteve, pistës në det dhe dy pishina.
18. Prishja e ndërtimeve prej IKMT-së është kryer mbi bazë të vendimit nr.342, datë 26.08.2022 “*Për prishjen e objektit të kundërligjshëm*”, akt i cili i është vënë në dispozicion “Erjoni” shpk sikurse lartpërmendur, më datë 02.09.2022. Sipas këtij vendimi, IKMT-ja ka vendosur: “*Dënimin e kundërvajtësit “Erjoni” shpk me prishjen e objektit të kundërligjshëm pistë në det me sipërfaqe rreth 4,500 m², pishina me sipërfaqe rreth 590 m²; 450 m² ndodhur në adresën: Kompleksi Turistik “Prestige Holiday Resort” Golem, Bashkia Kavajë*”. **Pra, IKMT-ja në kundërshtim me detyrimin e parashikuar në nenin 15 të K.Pr.C. për dhënien e ndihmesës për zhvillimin normal të hetimit gjyqësor, nuk ka bërë të ditur ekzistencën e vendimit 342, datë 26.08.2022 dhe nr.343, datë 26.08.2022, (faktit) të IKMT-së në seancën gjyqësore të zhvilluar më datë 31.08.2022. Ky proces gjyqësor, kërkesë për sigurimin e objektit të padisë, është zhvilluar në kushtet e marrjes dije prej “Erjoni” shpk vetëm të proces-verbalin nr.29, datë 25.08.2022 “Për konstatimin e kundërvajtjes”.**
19. Shoqëria “Erjoni” shpk, më datë 02.09.2022 ka paraqitur përsëri kërkesë për sigurimin e padisë (ditë e premtë), por për shkak të procedurës së njoftimeve, seanca gjyqësore për shqyrtimin e çështjes nga gjykata është caktuar më datë 06.09.2022 (duke patur parasysh fundjavën dhe datën 05.09.2022, festë zyrtare).
20. IKMT-ja ka vijuar prishjen e objekteve nga data 02.09.2022 deri më 05.09.2022. Përtej sipërfaqeve të përcaktuara në aktin nr.342, datë 26.08.2022, për prishjen e pishinës në masën 450 m², është prishur prej IKMT-së pishina në masën 820 m², ndërsa pishina e dytë është prishur në masën 700 m² nga 590 m² të përcaktuar në aktin e lartpërmendur. Po kështu, pista është prishur në masën 4600 m² nga 4500 m² të përcaktuar në vendimin nr.342, datë 26.08.2022. Të dhënat e prishjes së objekteve janë pasqyruar në aktin topografik të realizuar prej studios së inxhinjerisë topografike “G-O PROJEKT”.

21. Shqyrtimi kërkesës për pezullimin e prishjes së ndërtimeve prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, më datë 06.09.2022, në kushtet e prishjes së ndërtimeve prej IKMT-së si dhe mbajtjes së proces verbalit datë 05.09.2022, në përfundim të prishjes, ka bërë që kërkesa e shoqërisë “Erjoni” shpk për pezullim të prishjes së objekteve të mbetej pa objekt.
22. Ndërkohë shoqëria “Erjoni” shpk ka vijuar me ngritjen e padisë duke kundërshtuar vendimin nr.342, datë 26.08.2022 dhe nr.343, datë 26.08.2022, për pavlefshmëri ligjore të tyre. Procesi shqyrtimit të padisë rezulton i papërfunduar prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
23. Në vijim të veprimtarisë mbi ndërtimet e kompleksit turistik “*Prestige Holiday Resort*”, IKMT në datë 01.12.2022, ka vendosur rrethimin e të gjithë kompleksit në prani të forcave të Policisë së Shtetit. Zhvillimi i veprimtarisë në fjalë prej IKMT-së nuk është zhvilluar me mbajtjen dhe vënien në dispozicion të subjektit “Erjoni” shpk të dokumentacionit që do të justifikonte rrethimin e kompleksit.
24. Kundër këtij veprimi të IKMT-së, subjekti “Erjoni” shpk, ka depozituar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, kërkesë për sigurimin e padisë. Zhvillimi seancës gjyqësore për shqyrtimin e kërkesës datë 02.12.2022, u caktua më datë 05.12.2022. Më datë 04.12.2022, Godina nr.5 e “*Prestige Holiday Resort*” shkatërrohet me eksploziv nga IKMT-ja dhe forcat xheniere të Ministrisë së Mbrojtjes.
25. Më datë 05.12.2022, në seancën për shqyrtimin e sigurimit të padisë, subjekti ankues “Erjoni” shpk është njohur me aktet e nxjerra prej IKMT-së si: Proces verbal nr.6, datë 25.11.2022 “*Për Konstatimin e Kundërvajtjes*”, vendim nr.464, datë 30.11.2022 “*Për Prishjen e Objektivit të Kundërligjshëm*”; vendim nr.465, datë 30.11.2022 “*Për Dënim me Gjobë*”, të cilat nuk i ishin njoftuar më parë apo dhe sot në formën origjinale apo të njehësuar me origjinalin, sikundër kërkon procedura përkatëse.
26. Për të gjitha sa më sipër, përpos padive gjyqësore, prej subjektit “Erjoni” shpk janë paraqitur dhe kallëzime penale pranë organit të Prokurorisë.

Me qëllim trajtimin e plotë dhe të gjithanshëm të çështjes dhe arritjen e konkluzioneve të drejta e ligjore, hetimi administrativ u orientua mbi çështjen e respektimit të së drejtës për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe të së drejtës të pronësisë/posedimit mbi pasurinë e subjektit “Erjoni” shpk, objekt prishjeje prej IKMT-së.

Në veprimtarinë administrative të kryer prej IKMT, nuk konstatohet respektimi i së drejtës të subjektit të prekur për t’u dëgjuar gjatë këtij procesi administrativ të zhvilluar. Referuar akteve si më sipër përshkruar dhe administruar, konstatohet se procedura administrative mbi objektet e prishura apo vendoja e masës së gjobës ka nisur kryesisht prej IKMT-së, me mbajtjen e akteve si më sipërshkruar.

Në zhvillimin e kësaj procedure gjykojmë se nuk janë repektuar detyrimet ligjore sikurse parashikuar në nenin 42/1/2 të Kodit të Procedurës Administrative, se:

“Komunikimi me palët

1.Në rastet kur procedura administrative fillohet nga organi publik, ky i fundit njofton të gjitha palët në proces për fillimin e veprimtarisë.

2.Njoftimi sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet me shkrim apo në një takim me palën dhe përmban këto të dhëna:

a) adresën postare dhe/ose elektronike të organit publik, që zhvillon procedurën dhe nëpunësin përgjegjës për të;

b) informacion lidhur me kompetencën e organit publik, qëllimin e procedurës dhe çështjet për të cilat do merren vendime;

c) palët në procedurën administrative;

ç informacion për të drejtën e njohjes së dosjes dhe zyrën ose vendin ku mund të njihet dosja;

d) informacion për të drejtën e palës për të dëgjuar, mënyrat dhe afatin e ushtrimit të kësaj të drejte;

dh) datën e fillimit të procedurës dhe afatin brenda të cilit do të merret dhe njoftohet vendimi përfundimtar, në rast se zbatohet një afat i tillë;

3. Kur njoftimi bëhet me takim, organi publik mban procesverbal për dokumentimin e veprimit të kryer;

4. Organi publik nuk është i detyruar të komunikojë me palët në rastet kur çështja është “Sekret shtetëror”...”

Në këtë procedurë të zhvilluar, KKT-ja ka kufizuar në mënyrë të paligjshme të drejtën e subjektit “Erjoni” shpk për njohje me dosjen gjatë fazës së shqyrtimit të çështjes, sikurse parashikuar në nenin 46 të K.Pr.A., se:

“Kufizimi i së drejtës së palëve për njohje me dosjen

Të gjitha palët, në çdo fazë të procedurës, kanë të drejtë të paraqesin mendime dhe shpjegime për faktet, rrethanat apo çështjet ligjore, si dhe të depozitojnë prova ose të paraqesin propozime për zgjidhjen e çështjes”.

Ky qëndrim i mbajtur prej KKT-së, në fazën e hetimit administrativ, vjen ndesh me detyrimin për bashkëpunim, sikurse parashikuar në nenin 78 të K.Pr.A. se:

“ Bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ

1. Pala bashkëpunon me organin publik në përcaktimin e fakteve dhe rrethanave të nevojshme për zgjidhjen e çështjes. Ligji mund të parashikojë shprehimisht detyrimin e mëtejshëm të palës për të paraqitur informacione, prova, dokumente, deklarata apo për t’u paraqitur personalisht përpara organit publik.

2. Palëve nuk mund t’u kërkohet të paraqiten personalisht pranë organit publik, nëse komunikimi me to mund të sigurohet me mjete të tjera më të përshtatshme.

3. Palët mund t’i paraqesin deklaratat e tyre në formë të shkruar apo verbale. Për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes, palëve mund t’u kërkohet t’i paraqesin deklaratat e tyre me shkrim”.

Kjo situatë paligjshmërie në procedimet administrative të zhvilluara, konstatohet dhe në mosrespektimin e detyrimit ligjor për njoftimin dhe dëgjimin e subjektit “Erjoni” shpk përpara marrjes së vendimeve përfundimtare, sikurse parashikuar në nenin 87 të K.Pr.A., se:

“Njoftimi dhe e drejta për t’u dëgjuar para marrjes së vendimit përfundimtar

1. Përpara se të merret vendimi përfundimtar, organi publik, përveç rasteve të parashikuara nga neni 64, i këtij Kodi, njofton palën lidhur me të drejtën e saj për t’u dëgjuar.

2. Njoftimi, sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet me shkrim, apo në një takim me palën, dhe përmban këto të dhëna:

a) organin publik që zhvillon procedurën dhe nëpunësin publik përgjegjës;

b) palët e përfshira; c) informacion për të drejtën e inspektimit të dosjeve dhe zyrës dhe vendin ku kjo mund të ushtrohet;

ç) provat e administruara, rezultatet e hetimit, si dhe rezultatet e pritshme të procedurës administrative dhe motivimin përkatës;

d) informacionin për të drejtën e palës për t'u dëgjuar dhe mënyrën dhe afatin e ushtrimit të kësaj së drejte;

dh) datën e fillimit të procedurës dhe afatin kohor, brenda të cilit do të merret dhe njoftohet vendimi, në qoftë se një afat i tillë është i zbatueshëm.

3. Afati i parashikuar sipas shkronjës "dh", të pikës 2, të këtij neni, nëse nuk parashikohet nga ligji ose aktet nënligjore, përcaktohet nga organi publik, në përputhje me nenin 53 të këtij Kodi.

IKMT-ja në procedimet administrative të zhvilluara, nuk rezultonë të kenë respektuar të drejtën e subjektit "Erjoni" shpk për t'u dëgjuar, sikurse parashikuar respektivisht në nenin 88 dhe 89 të K.Pr.A., se:

"Neni 88

Ushtrimi i së drejtës për t'u dëgjuar

1. E drejta e palës për t'u dëgjuar ushtrohet në çdo formë të përshtatshme dhe brenda afatit të përcaktuar nga organi publik.

2. Palët, në ushtrimin e së drejtës për t'u dëgjuar, mund të paraqesin komente edhe për vlerësimin e provave të administruara, rezultatet e hetimit dhe rezultatit e mundshëm të procedurës.

3. Organi publik merr vendimin përfundimtar vetëm pas kalimit të afatit të përcaktuar për ushtrimin e së drejtës për t'u dëgjuar nga pala. Mosushtrimi i kësaj së drejte nga ana e palës në afatin e përcaktuar, nuk shkakton shtyrjen e marrjes së vendimit përfundimtar.

Neni 89

Përfundimi nga e drejta për t'u dëgjuar Procedura administrative mund të mbyllet pa njoftuar dhe pa i dhënë mundësinë palës për t'u dëgjuar, vetëm në rastet e mëposhtme:

a) marrja e vendimit përfundimtar është urgjente, për shkak të dëmit që mund t'i shkaktohet për shkak të vonësës interesit publik;

b) palët kanë paraqitur paraprakisht mendimet, komentet dhe shpjegimet e plota gjatë procedurës administrative;

c) gjatë zhvillimit të procedurës administrative rezulton qartë se vendimi do të jetë tërësisht në favor të palës;

ç) në një procedurë administrative që bazohet në një procedurë konkurruese publike; ose kur

d) është parashikuar shprehimisht me ligj".

Gjithë sa parashtruar më sipër, vlerësojmë të sjellim gjithashtu në vëmendje, qëllimin që mbart K.Pr.A. në vetvete në lidhje me veprimtarinë e organeve publike dhe për të cilin ligjvënësi ka paraparë hartimin e tij, i cili është përcaktuar në nenin 1 të tij, sipas të cilit:

"Ky kod ka për qëllim të sigurojë realizimin efektiv të funksioneve publike administrative në shërbim të personave, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshëm të tyre, në realizimin e këtyre funksioneve, duke zbatuar parimin e procesit të rregullt ligjor".

Pra vetë Kodi ka përcaktuar se organet e administratës publike, realizimin efektiv të funksioneve të tyre e mbështesin në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të qytetarëve, në zbatim rigoroz të procesit të rregullt ligjor. Çdo veprimtari administrative duhet të mbështet tek ky qëllim i kodit pasi në të kundërt do të përbënte veprimtari të

paligjshme duke dalë jashtë përcaktimeve ligjore. Në mbështetje të këtij arsyetimi i referohemi nenit 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i cili parashikon se e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit, që nënkupton të gjithë veprimtarinë e organeve publike dhe enteve të tjera. Kjo do të thotë se e gjithë veprimtaria e enteve publike, veçanërisht ajo e organeve publike duhet të jetë në përputhje me ligjin, e në këtë rast me K.Pr.A.. Këto funksione burojnë kryesisht edhe nga parimi i shtetit të së drejtës. Zbatimi i saktë dhe i plotë i kërkesave dhe dispozitave të ligjit duhet të shihet si funksioni më i rëndësishëm i organeve administrative. Zbatimi i kërkesave të shtetit të së drejtës duke siguruar procedura ligjore që garantojnë zbatimin e paanshëm të ligjit, pjesëmarrjen e personave të prekur, transparencën e proceseve vendimmarrëse dhe luftën ndaj tendencave të korrupsionit e më gjerë, është qëllimi themelor i K.Pr.A.. Këto synime duhet të ndiqen jo vetëm duke zbatuar të drejtën materiale, por edhe duke parashikuar kërkesa specifike procedurale, si dhe duke siguruar mjete efektive për të mbrojtur të drejtat individuale dhe interesat e ligjshme të personave të prekur. Në mbështetje të këtij arsyetimi është edhe neni 41 i Kartës Evropiane të të Drejtave Themelore i cili përfshin të drejtën për një Administrim të Mirë të organeve publike, ku përfshihen të gjitha parimet e renditura në nenin 1, sipas të cilës, zbatimi i rregullave procedurale që kanë si objekt arritjen e qëllimeve të administrimit të mirë duhet të shihet si një element kryesor i *acquis communautaire*. Në rastin objekt shqyrtimi administrativ, rezulton se IKMT-ja nuk ka siguruar realizimin efektiv të të drejtave dhe interesave të ligjshme të subjektit “Erjoni” shpk duke i cënuar në mënyrë sistematike e strukturore ato. Nga ana tjetër, në përputhje me pikën 2, të nenit 15, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre. Ligji për Avokatin e Popullit, si një organ kushtetues, vendos këtë të fundit në funksion të ushtrimit të detyrave të tij, si një rojtar të të drejtave të njeriut. Dhe në përmbushje të këtij funksioni Avokati i Popullit i drejtohet organeve të administratës në nivel qendror dhe vendor¹ për dhënien e informacioneve dhe dokumentacionet e plota mbi çdo rast që është në një hetim administrativ prej tij. Në rastin konkret konstatojmë me shqetësim të vazhdueshëm faktin se organi shtetëror, IKMT-ja, nuk është bashkëpunuese përgjithësisht dhe veçanërisht në rastin konkret, gjatë procesit administrativ të zhvilluar nga Avokati i Popullit për sqarimin e pretendimit të subjekti “Erjoni” shpk. Shtojmë se në shkresën drejtuar IKMT-së, është lënë një afat prej 10 ditësh për kthim përgjigje, por nuk janë kthyer përgjigjet brenda këtij afati².

Gjatë hetimit administrativ të kësaj çështjeje, rezulton se IKMT-ja, dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë kavajë, kanë shkelur dhe cënuar një ndër parimet më të

¹ Ligji nr. Nr.8454 , date 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar

Neni 18 - Procedura pas pranimit të ankesës, kërkesës apo njoftimit për shqyrtim: Pas pranimit të ankesës, kërkesës apo njoftimit për shqyrtim, Avokati i Popullit kryen njërën nga veprimet e mëposhtme: a): ndërmerr vetë një proces hetimi; b): kërkon shpjegime nga organet e administra-tës, si dhe prokuroria, në rastet e arrestimeve dhe ndalimeve; c): i rekomandon Kontrollit të Lartë të Shtetit të ushtrojë funksionet e veta.

Neni 19 - Procedura e hetimit: Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë:a): të kryejë hetime në vend, përfshirë edhe hyrjen në çdo zyrë të institucioneve publike dhe këqyrjen në vend të akteve apo dokumenteve që kanë lidhje me çështjen që heton.b): të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin;c): të marrë në pyetje çdo person që, sipas tij, është i lidhur me çështjen nën hetim, dhe të thërrasë në zyrën e tij të gjithë personat pa imunitet;ç): të kryejë ose të kërkojë ekspertiza. Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme.

²Në referim të përcaktimeve ligjore e konkretisht të nenit 19 të Ligjit Nr.8454 , date 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet: “Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme”,

rëndësishme, të parashikuar në K.Pr.A., parimin e bashkëpunimit ndërmjet organeve të administratës publike. Ky fakt në gjykimin e Avokatit të Popullit është një element shumë i rëndësishëm pasi institucioni ynë, në mungesë të këtij informacioni dhe dokumentacioni pengohet të ushtrojë misionin e ngarkuar nga kushtetuta dhe ligji. Nga kjo qasje, pamundësohet vlerësimi tërësor i veprimtarisë së organeve të administratës publike, në zbatimin e një procesi të rregullt ligjor gjatë procesit të vendimarrjes lidhur me shpronësimin e pasurive objekt shqyrtimi administrativ dhe strehimin e banorëve të prekur nga kjo procedurë. Mosdhënia e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar, përbën shkelje të parimeve kushtetuese dhe ligjore. Gjithashtu, duhet theksuar se bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ është i lidhur ngushtësisht me parimin e transparencës dhe atë të llogaridhënies³. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 63 të saj e ka ngritur në nivel kushtetues detyrimin e organeve të administratës shtetërore dhe funksionarëve publikë, për bashkëpunim me institucionin e Avokatit të Popullit dhe të drejtën e këtij të fundit për të kërkuar informacion e dokumentacion⁴. Në funksion të përmbushjes së këtij detyrimi nga institucionet përgjegjëse, edhe ligji nr. 8454/1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, parashikon të drejtën e institucionit tonë për marrjen e masave administrative në rast të refuzimit për bashkëpunim nga organet e administratës publike apo nëpunësit e tyre. Ky ligj shkon edhe më tej duke parashikuar deri edhe propozimin apo rekomandimin drejtuar prokurorisë, për fillimin e procedimit penal, në rast të konstatimit të elementëve të veprës penale nga nëpunësit e administratës publike⁵.

Duhet theksuar se Avokati i Popullit si institucion kushtetues, ka rol “kontrollues” mbi veprimtarinë e organeve të administratës publike në lidhje me zbatimin e respektimin e të drejtave kushtetuese, duke ndihmuar individët që t’u krijohen shanse të barabarta, të mund të trajtohen si të barabartë në çdo marrëdhënie me administratën publike, përveç gjykatave. Mungesa e bashkëpunimit duket se bëhet me qëllim shmangien e kontrollit nga institucioni kontrollues (AP) dhe lind dyshimi i arsyeshëm se institucioni që refuzon të japë informacion, mund të ketë kryer veprimtari të parregullt e të paligjshme gjatë procesit të tij administrativ, të cilat refuzon të bëhen të ditura kundrejt institucionit kontrollues. Në rastet kur ka pretendime nga individët për veprimtari të paligjshme apo të parregullta të organeve të administratës publike, barra e provës bie mbi këto organe të provojnë të kundërtën e pretendimeve, me anë të dokumentacionit dhe informacionit provues⁶ si dhe uljen e besimit tek organet shtetërore.

³Organet e administratës publike janë të detyruara të bashkëpunojnë për të mbështetur organin publik që kryen hetimin administrativ në funksion të përcaktimit të fakteve dhe rrethanave të çështjes. Transparenca dhe llogaridhënia janë dy nga parimet kryesore të mirëqeverisjes në administratën publike. Misioni i institucionit të Avokatit të Popullit në këtë drejtim është të kontribuojë në transparencën dhe llogaridhënien e organeve publike sa i përket ushtrimit të veprimtarisë administrative nga ana e tyre.

⁴Neni 63 përcakton se: “Avokati i Popullit paraqet raport vjetor përpara Kuvendit. 2. Avokati i Popullit raporton përpara Kuvendit kur i kërkohet prej këtij, si dhe mund t’i kërkojë Kuvendit të dëgohet për çështje që ai i çmon të rëndësishme. 3. Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike. 4. Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”.

⁵ Neni 21/ç i ligjit përcakton se Avokati i Popullit, mund të kryejë këto veprime: ç) “i rekomandon prokurorisë të fillojë hetime në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një veprë penale; ose të rifillojë hetimet e pushuara ose të pezulluara”. Ndërsa neni 22 i këtij ligji përcakton se: “Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”.

⁶ Duhet theksuar fakti se legjislatori ka paraparë si veçori themelore të institucionit të Avokatit të Popullit, veç pavarësisë nga institucionet e tjera dhe nga çdo ndikim politik, lehtësinë e kontaktimit, shpejtësinë dhe fleksibilitetin në kapjen e problemeve, si dhe mungesa e shpenzimeve, pasi veprimtaria e tij është pa pagesë. Mungesa e informacionit dhe dokumentacionit, si dhe dërgimi i përgjigjeve të pjesshme apo tej afatit të

Sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në përputhje me nenin 22/1, të ligjit 8454/1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit..., paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”, si dhe kërkesave të ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, për parashikimin e procedurave që duhen ndjekur për kërkimin dhe përmbushjen e dëmshpërblimit,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave nga IKMT, për nxjerrjen e përgjegjësive dhe evidentimin e personave, që kanë çuar në shkeljen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të subjektit “Erjoni” shpk, të prekur nga shembja/prishja pa një proces të rregullt ligjor i objekteve në zonën e Golemit, Bashkia Kavajë.

Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, kthimi përgjigjes mbi qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi dhe masat e marra për rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura, të kryhet në afatin ligjor prej 30 ditësh nga data e dërgimit të këtij rekomandimi.

Me besim në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj.

**Në mungesë dhe me urdhër
KOMISIONERI**

Ahmet PRENÇI

përcaktuar dhe atij të arsyeshëm ligjor, sjell zvarritjen e procesit administrativ dhe mohimin e të drejtës së qytetarëve për të gëzuar efektivisht të drejtat e tyre kushtetuese dhe për të përdorur mekanizmat kushtetues për garantimin e tyre. Kjo gjithashtu minon besimin e qytetarëve tek shteti i së drejtës dhe administrata shtetërore ndërkohë që të gjitha përpjekjet në nivel evropian por edhe të Këshillit të Evropës janë të drejtuara për nga ruajtja e besimit të publikut dhe përmirësimi i këtij indikator.

